

PROTOKOLL PER ZBATIMIN E MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT KERKIMOR- SHKENCOR MIDIS AKADEMISE SE SHKENCAVE TE SHQIPERISE DHE AKADEMISE SE SHKENCAVE DHE TE ARTEVE TE KOSOVES

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosoves, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor të nënshkruar ndërmjet tyre më 8 shtator 2000 në Tiranë, ranë dakord të ndërmarrin veprimtaritë e mëposhtme:

1. Hartimi i përbashkët i veprës “Historia e Popullit Shqiptar”.
2. Hartimi i Platformës së Enciklopedisë Shqiptare.
3. Organizimi i veprimtarive shkencore me rastin e 30-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit.
4. Bashkërendimi i punës në fushë të terminologjisë tekniko-shkencore.
5. Hartimi i “Fjalorit të bimësisë shqiptare”
6. Botim i përbashkët i punimeve dhe i akteve të Simpoziumeve, të Konferencave ose Kongreseve të organizuara bashkërisht.
7. Organizimi i ekspeditave të përbashkëta në Shqipëri e në Kosovë: në fushën e arkeologjisë; në fushën e etnografisë; në fushën e gjeografisë dhe në fusha të tjera

Për secilën prej veprimtarive do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të të dy Akademive.


Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuar në këtë Protokoll, përfaqësues të të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të përcaktohen me korrespondencë.

Ky protokoll mund të ndryshohet ose të shtohet me miratimin e të dy palëve.


Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.

Nënshkruar në Tiranë më 8 shtator 2000 në dy kopje me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

**PER AKADEMINE E SHKENCAVE
DHE TE ARTEVE TE KOSOVES**

KRYETARI

PROF.DR.NEXHAT DACI

**PER AKADEMINE E SHKENCAVE
TE SHQIPERISE**

KRYETARI

PROF. YLLI POPA